



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5367/1 Prot.

Tiranë, më 30.08. 2024

U R D H Ë R

Nr. 463, datë 30.08.2024.

PËR

**PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR MIRATIMIN E “MËSUESIT  
KOORDINATOR PËR SIGURIMIN E CILËSISË” DHE TË “MËSUESIT  
KOORDINATOR TË KËSHILLIMIT TË KARRIERËS” NË INSTITUCIONET  
ARSIMORE PUBLIKE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar” dhe të urdhrin nr. 565, datë 05.10.2023 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Nina Guga”, të ndryshuar,

U R D H Ë R O J:

1. Në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar (shkollat), që përfshijnë nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe/ose arsimin e mesëm të lartë të caktohen rolet e reja të mësuesit koordinator i sigurimit të cilësisë dhe mësuesit koordinator për këshillimin e karrierës.
2. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë ka për detyrë të vlerësojë, analizojë dhe monitorojë periodikisht dhe në vijimësi, ecurinë e zhvillimit profesional të mësuesve në shkollën/shkollat që mbulon, të kontribuojë në vlerësimin e indikatorëve të cilësisë së mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, të mbështesë stafin/et drejtues/e për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, si dhe të organizojë punën për përmirësimin e performancës dhe cilësisë së procesit të mësimdhënies-nxënies, bazuar në udhëzuesit e përcaktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në koordinim me drejtorinë e shkollës/shkollave dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar (AKAP).
3. Në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, që kanë më shumë se 480 nxënës që ndjekin nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe/ose arsimin e mesëm të

lartë, caktohet 1(një) mësues koordinator i sigurimit të cilësisë, ndërsa për çdo grup shkollash që mbulojnë një kapacitet me jo më pak se 480 nxënës që ndjekin nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe/ose arsimin e mesëm të lartë, caktohet 1(një) mësues koordinator i sigurimit të cilësisë. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë përgjigjet për detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara dhe e ka normën mësimore 6-10 orë në javë.

4. Mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë, duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor dhe duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:
  - a) Të ketë 8 vite punë si mësues, nga të cilat 5 vite në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të sigurimit të cilësisë ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.
  - b) Të ketë kategorinë “Mësues specialist” me rezultat “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”. Avantazh përbën rezultati “Shkëlqyeshëm”.
  - c) Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin “Shumë mirë” për tri vite radhazi.
  - d) Të ketë kryer prezantimin e një projekti novator për zhvillimin e lëndës, që dëshmohej nga institucioni arsimor përkatës.
  - e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.
5. Mësuesi koordinator për këshillimin e karrierës ka për detyrë të hartojë planin e orientimit dhe këshillimit të karrierës për nxënësit në shkolla dhe të orientojë nxënësit për ndjekjen e niveleve të arsimit, për prirjet dhe talentet e secilit, në mbështetje të orientimit dhe këshillimit të karrierës, bazuar në udhëzimet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, në koordinim me drejtorinë e shkollës/shkollave, mësuesit lëndorë, mësuesin kujdestar, punonjësin e shërbimit psiko-social dhe prindërit/përfaqësuesit ligjorë të nxënësve dhe Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.
6. Në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, që kanë më shumë se 480 nxënës që ndjekin nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe/ose arsimin e mesëm të lartë, caktohet 1(një) mësues koordinator i këshillimit të karrierës, ndërsa për çdo grup shkollash që mbulojnë një kapacitet me jo më pak se 480 nxënës që ndjekin nivelin e arsimit të mesëm të ulët dhe/ose arsimin e mesëm të lartë, caktohet 1(një) mësues koordinator i këshillimit të karrierës. Mësuesi koordinator i këshillimit të karrierës përgjigjet për detyrat dhe përgjegjësitë e ngarkuara dhe e ka normën mësimore 8-12 orë në javë.
7. Mësuesi koordinator i këshillimit të karrierës duhet të jetë pjesë e sistemit arsimor dhe duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:
  - a) Të ketë 5 vite punë si mësues, ndër të cilat 3 vite si mësues në shkollën ku punon dhe aplikon për mësues koordinator të këshillimit të karrierës ose në shkollën me numër më të madh nxënësish.
  - b) Të ketë përfutuar kategorinë “Mësues i kualifikuar” me rezultat “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm”. Avantazh përbën rezultati “Shkëlqyeshëm”.



- c) Të jetë vlerësuar në matjen e performancës vjetore të mësuesit me vlerësimin “Shumë mirë” për dy vite radhazi.
  - d) Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe njohuri në fushën e aktiviteteve që mbështesin zhvillimin e talenteve të nxënësve, të cituara në vlerësimet periodike të mësuesit në shkollë apo certifikata në trajnime.
  - e) Të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe aftësi shumë të mira kompjuterike.
8. Procedurat e përzgjedhjes së mësuesit koordinator të sigurimit të cilësisë dhe mësuesit koordinator të këshillimit të karrierës janë:
- a) Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar përmes zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) miraton numrin e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë dhe mësuesve koordinatorë të këshillimit të karrierës për shkollat, sipas përcaktimeve në këtë urdhër.
  - b) ZVAP harton planin e organizimit mbi bazë afërsie gjeografike të shkollave dhe përcaktojnë shkollat, të cilave do t’u vendoset mësues koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësues koordinator për këshillimin e karrierës, ku bazuar në numrin e nxënësve, qendra e punës së mësuesit koordinator, do të jetë shkolla me numrin më të madh të nxënësve, bazuar në pikën 3 dhe në pikën 6 të këtij urdhri.
  - c) ZVAP organizon procesin e njoftimit, përzgjedhjes për emërimin e mësuesve koordinatorë të sigurimit të cilësisë dhe mësuesve koordinatorë për këshillimin e karrierës, bazuar në procedurën e përcaktuar nga AKAP.
  - d) Dorëzimi i dosjeve të aplikimit bëhet në ZVAP-in përkatës.
  - e) ZVAP ngre komisionin/et për përzgjedhjen e mësuesve koordinatorë në shkolla, që përbëhen nga:
    - i. 2 (dy) përfaqësues nga ZVAP, njëri prej të cilëve është kryetar;
    - ii. 1 (një) përfaqësues nga drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar (DRAP).
9. ZVAP, pas procesit të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së bërë nga komisioni, dërgon listën e mësuesve koordinatorë të përzgjedhur në çdo shkollë, të cilët emërohen nga drejtori i shkollës dhe informon AKAP.
10. Drejtori i shkollës përcakton çdo vit ngarkesën mësimore të mësuesit koordinator për sigurimin e cilësisë dhe mësuesit koordinator për këshillimin e karrierës bazuar në pikën 3 dhe pikën 6 të këtij urdhri, pa cenuar mbarëvajtjen e procesit mësimor sipas planit mësimor përkatës.
11. Në fund të vitit shkollor, drejtori i shkollës vlerëson performancën e mësuesve koordinatorë, bazuar në indikatorët e performancës të miratuar nga ASCAP, pjesë e vlerësimit periodik vjetor të mësuesit.
12. Mësuesit koordinatorë të sigurimit të cilësisë dhe mësuesit koordinatorë të këshillimit të karrierës, planifikojnë dhe realizojnë veprimtaritë e tyre për një periudhë 3-vjeçare. Në fund të periudhës 3-vjeçare ZVAP-et bëjnë vlerësimin e performancës së tyre, në bazë të të cilit përcaktohet vijimi i punës në rolin e koordinatorit apo rikthimi në pozicionin e mësuesit brenda ZVAP-it.

13. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar miraton protokollet e punës për rolet e reja të mësuesve koordinatorë, mekanizmat monitorues dhe raportues në shkolla si dhe organizon punën për trajnimin e tyre.
14. Aplikojnë për mësues koordinatorë për sigurimin e cilësisë dhe mësues koordinatorë për këshillimin e karrierës, mësuesit me kontratë pune me afat të pacaktuar të institucionit arsimor ku krijohen këto pozicione, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë urdhër.
15. Në rast se nuk paraqiten aplikime që përmbushin pikën 14 të këtij urdhri dhe/ose aplikantët nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë urdhër, për këto pozicione mund të aplikojnë mësues me kontratë pune me afat të pacaktuar nën juridiksionin e ZVAP-së përkatëse, në varësi të ngarkesës së tyre mësimore pa cenuar planin lëndor përkatës. Procedurat e shpalljes për këtë pikë, njoftohen në faqet zyrtare të institucionit që organizon thirrjen për aplikim, sipas procedurës së miratuar nga AKAP.
16. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore publike parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSMINISTËR**

**NINA GUGA**

